



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 467/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për apelin e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të PZAP-it, Anr. 379/2010 të datës 11.12.2010, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

I MIRATOHET si i bazuara apeli i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për rishqyrtimin e vendimit të PZAP-t, Anr. 379/2010 të datës 11.12.2010.

II Ndryshohet vendimi i PZAP-it Anr. 379/2010 të datës 11.12.2010, ashtu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet gjoha në vlerë prej 3350 (tremijetreqindpesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një apel më datë 12.12.2010, nga subjekti politik LDK, me te cilën pretendohet se PZAP-i në vendimin më Anr. 379/2010 të datës 12.12.2010, nuk mori parasysh përgjigjen në ankesë edhe pse ky subjekt politik është përgjigjur në ankesë brenda kohës së caktuar nga PZAP-i. Në përgjigje ndaj ankesës me Anr. 379/2010 të datës 09.12.2010, nga subjekti politik LDK, është theksuar se nuk është e qartë nga kush është vendosur posterit, sipas subjektit politik LDK rregullisht i ka njoftuar anëtarët dhe simpatizantët për rregullat ligjore për vendosjen e posterave. Në përgjigje ndaj ankesës subjekti politik LDK ka bashkangjitur fotografi si provë.

Vendim i PZAP-it Anr. 379 të datës 11.12.2010, është marrë në bazë të dispozitave ligjore të Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) i Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Neni 118 paragrafi 4 i LZP-së parasheh;

118.4 Mund të apelohet vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuara.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se subjekti politik LDK, ka bërë përpjekje për të evituar shkeljen e bërë që është marr si rrethanë lehtësuese nga PZAP-i dhe që ka ndikuar në ndryshimin e gjobës së shqiptuar në vendimin Anr. 379/2010 që ka qenë 3800 euro, për këtë arsye i zbritet gjoba e shqiptuar në vendimin Anr. 379/2010 të 11.12.2010 në vlerë prej 450 euro. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e lartcekura e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

A nr. 467/2010 më datën 23.12.2010

